



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO

KUVENDI I KOMUNËS ISTOG/ SKUPŠTINA OPŠTINE ISTOK/MUNICIPAL
ASSEMBLY ISTOG



01 Numër 55/08
Istog, më 18.11.2008

STATUTI I KOMUNËS SË ISTOGUT

Istog, tetor 2008

Përmbajtja

PJESA E I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	4
Përdorimi i gjuhëve	5
Organet e Komunës	6
PJESA E II. FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE	6
PJESA E III. KONSULTIMET DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE	7
Kapitulli 1. Konsultimi me publikun	7
Kapitulli 2. Tubimet me Publikun	9
Peticioni	10
Referendumi	10
Kapitulli i 3: Komitetet Këshillë-dhënëse Komunale	10
Kapitulli i 4. Qasja në Dokumentet Zyrtare	11
PJESA E IV. KUVENDI I KOMUNËS, KRYESUESI, ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT DHE KOMITETET E KUVENDIT	11
Kuvendi i Komunës	11
Kompetencat jo deleguese të Kuvendit të Komunës	12
Kompetencat deleguese të Kuvendit të Komunës	13
Kryesuesi i Kuvendit të Komunës	13
Zëvendëskryesuesi i komuniteteve	13
Mbledhja inauguruese.....	13
Kuorumi dhe mbledhjet e Kuvendit të Komunës	14
Vendimmarrja në Kuvend Komunal dhe Komitete.....	14
Procesverbali.....	15
Komitetet e përhershme komunale dhe Komitetet tjera	15
Komiteti për politikë dhe financa	15
Komiteti i komuniteteve	16
Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve.....	16
Rendi i ditës	17
Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës	18
PJESA E V. INFORMIMI PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS	18
Kapitulli i 1. Kompensimi i Anëtarëve të Kuvendit të Komunës	19
Kapitulli 2. Konflikti i Interesit i Anëtarëve të Kuvendit të Komunës	19
Shkarkimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës.....	19
Kapitulli i 3. Marrëdhëniet ndër-komunale	20
Kapitulli i 4. Procedurat buxhetore	20
Përgatitja e buxhetit komunal si dhe konsultimi me publikun.....	21
Kapitulli i 5. Raporti vjetor	22
PJESA VI: EKZEKUTIVI I KOMUNËS	23
Kapitulli i 1: Kryetari i Komunës	23
Kapitulli i 2. Nënkryetari i Komunës	25
Zyra komunale për Komunitete	25

PJESA VII: DREJTORATET KOMUNALE	25
Konflikti i interesit të Drejtorëve	26
PJESA VIII: SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL.....	26
Veprimet dhe aktet juridike.....	27
Ankesa dhe mbrojtja juridike	28
Kapitulli i 1. Pasuria e Komunës	28
PJESA E IX. PROCEDURAT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT.....	28
PJESA X: DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE.....	29

Bazuar në nenin 12.2 pika a, 12.3 dhe 40.2 pika a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008), Kuvendi i Komunës së Istogut, në mbledhjen e mbajtur më: 18.11.2008, miratoi:

**STATUTIN
E
KOMUNËS SË ISTOG-ut**

PJESA E I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

- 1.1. Komuna e Istogut është njësi themelore e vetëqeverisjes lokale e cila ka Statutin e vetë.
- 1.2. Statuti i Komunës, është akti më i lartë juridik i Komunës që miratohet nga Kuvendi i Komunës në procedurë të veçantë në pajtim me nenin 12.3. të LVQL.
- 1.3. Statuti rregullon organizimin e brendshëm të Komunës dhe përcakton përgjegjësitë e Komunës dhe organeve të saj.

Neni 2

- 2.1. Komuna përgjegjësitë e veta i ushtron, organizon dhe udhëheq në pajtueshmëri të plotë me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008, Statutin e Komunës dhe Rregulloren e punës së Kuvendit.

Neni 3

- 3.1. Statuti i Komunës zbatohet vetëm brenda kufijve të Komunës së Istogut.
- 3.2. Selia e Komunës së Istogut është në Istog, rruga: "2 Korriku".
- 3.3. Komuna brenda territorit të vetë ushtron ato përgjegjësi të cilat nuk i janë rezervuar shprehimisht pushtetit qendror dhe mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuese me komunat tjera në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 4

- 4.1. Komuna e ka statusin e personit juridik.

4.2. Komuna ka të drejtën e posedimit dhe administrimit të pronës komunale, mundësinë për të ushtruar padi dhe për të qenë e paditur në gjykata, të drejtën për të lidhur kontrata dhe të drejtën për të marrë punëtorë në punë.

Neni 5

5.1. Komuna e Istogut ka emblemën e vetë.

5.2. Përmbajtja dhe përdorimi i emblemës përcaktohet me vendim të posaçëm të Kuvendit të Komunës.

5.3. Asnjë subjekt dhe person tjetër nuk mund të përdor emblemën dhe shenjat tjera komunale apo simbolet pa autorizim paraprak të dhënë nga organet kompetente komunale.

Neni 6

6.1. Komuna e ka vulën e vetë.

6.2. Forma, madhësia, përmbajtja dhe mënyra e mbajtjes dhe përdorimit të vulës së Komunës, rregullohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 7

7.1 Ndryshimi i kufijve të territorit të Komunës bëhet nga Pushteti Qendror, pas marrjes së pëlqimit paraprak nga Kuvendi i Komunës dhe pas mbajtjes së referendumit.

Neni 8

8.1. Komuna e Istogut e ka festën e vetë.

8.2. Festa e Komunës së Istogut është 20 Qershori, Dita e Çlirimit të Komunës.

8.3. Me rastin e festës së Komunës, Kuvendi i Komunës ndanë: dekorata, mirënjohje, falënderime dhe shpërblime tjera dhe shpallë tituj nderi.

8.4. Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë përcakton kushtet dhe mënyrën e dhënies së shpërblimeve, dekoratave, mirënjohjeve dhe titujve të nderit.

Neni 9.

9.1 Qytetar i Komunës është çdo qytetar i përhershëm i Republikës së Kosovës i cili jeton në Komunën e Istogut.

Përdorimi i gjuhëve

Neni 10.

10.1. Çdo komuniteti i garantohet e drejta e komunikimit në gjuhën e vet amtare, ndërkaq, gjuhë zyrtare në institucionet komunale është gjuha shqipe dhe gjuha serbe, ndërsa gjuhë zyrtare në përdorim të barabartë është edhe gjuha boshnjake.

10.2. Përdorimin e gjuhëve zyrtare në institucionet komunale më hollësisht, Kuvendi i Komunës do ta rregullojë me rregullore të veçantë në pajtueshmëri të plotë me Ligjin për përdorimin e gjuhëve nr.02/L-37.GZ nr.10.

Organet e Komunës

Neni 11.

11.1 Organet e Komunës janë:

1. Kuvendi i Komunës, si organi më i lartë vendimmarrës i Komunës dhe
2. Kryetari i Komunës, si organi më i lartë ekzekutiv i Komunës.

PJESA E II. FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

Neni 12.

12.1. Komuna e Istogut është e përbërë prej fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

12.2. Fshatrat e Komunës së Istogut janë më sa vijon:

- | | |
|----------------------|---------------------|
| 1. Banjë, | 23. Llukac i Thatë, |
| 2. Banjicë, | 24. Lubovë, |
| 3. Belicë, | 25. Lubozhdë, |
| 4. Bellopojë, | 26. Mojsir, |
| 5. Carallukë, | 27. Muzhevinë, |
| 6. Cërrkolez, | 28. Orrobërdë, |
| 7. Cerrcë, | 29. Osojan, |
| 8. Dobrushë, | 30. Polanë, |
| 9. Dragolec | 31. Prekallë, |
| 10. Drejë, | 32. Prigodë |
| 11. Dubovë e Vogël | 33. Rakosh, |
| 12. Dubravë, | 34. Serbobran, |
| 13. Gjurakoc | 35. Shalinovicë, |
| 14. Istog, | 36. Shushicë, |
| 15. Istog i Poshtëm, | 37. Sinajë, |
| 16. Kaliqan, | 38. Staradran, |
| 17. Kashicë, | 39. Studenicë, |
| 18. Kërrninë | 40. Suhogërlle, |
| 19. Kosh, | 41. Tomoc, |
| 20. Kovragë, | 42. Trubuhoc |
| 21. Lluga | 43. Tuçep, |
| 22. Llukac i Begut, | 44. Uçë, |

45. Veriq,
46. Veriq i Ri,
47. Vrellë,

48. Zabllaq,
49. Zallq,
50. Zhakovë.

12.3. Emërimi dhe riemërimi i vendbanimeve përcaktohet me ligj e me propozim të Kuvendit të Komunës.

12.4. Vendbanimet urbane të Komunës së Istogut janë:

1. Istogu,
2. Banja,
3. Gjurakoci,
4. Vrella dhe
5. Rakoshi

Neni 13.

13.1 Kuvendi i Komunës do të sigurojë kushte që të gjitha shërbimet komunale të shtrihen në të gjitha lagjet, fshatrat dhe vendbanimet tjera në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe efikase, pa diskriminim ose favorizim politik.

13.2 Specifikimi, përkatësisht, përkufizimet e emërtimeve të organizimit administrativ si dhe mënyra e emërimit të personelit do bëhet në pajtim me ligjin përkatës që rregullon vetëqeverisjen lokale.

Neni 14.

14.1 Kuvendi i Komunës me rregullore të veçantë përcakton strukturën organizative dhe funksionale si dhe mundësinë e lidhjes së marrëveshjeve për bashkëpunim me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

PJESA E III. KONSULTIMET DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE

Kapitulli 1. Konsultimi me publikun

Neni 15.

15.1 Komuna do të bëjë konsultime, diskutime dhe debate me publikun në mënyrë që të sigurojë që vendimet e miratuara nga ana e saj të jenë të bazuara në faktet, pikëpamjet dhe përvojat e qytetarëve dhe të sigurohet që këto vendime të jenë të zbatueshme.

Neni 16.

16.1. Komuna gjatë punës së saj shfrytëzon secilën nga format parimore të dëgjimit dhe konsultimit me qytetarët, sipas nevojës dhe rrethanave, si në vijim:

1. Format e informimit dhe të publicitetit për të promovuar aktivitetet dhe programet komunale
2. Kontaktet me grupet profesionale, për t'i testuar dhe diskutuar politikat;
3. Anketat për zbatimin e politikave, përfshirë edhe informues kyç, klient dhe qytetarë të prekur nga këto politika,
4. Shpalljet publike të propozimeve për politika apo draft-rregullore, duke i thirrur për pjesëmarrje në prezantime,
5. Kontaktet dhe mbledhjet me grupet e interesit,
6. Takimet dhe dëgjimet publike dhe
7. Studimet për vlerësim të efektit.

16.2. Format tjera të konsultimeve parashihen në ligjin përkatës dhe rregulloren përkatëse komunale.

Neni 17

17.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, Kryetari i Komunës dhe të gjitha Komitetet e Kuvendit të Komunës kanë autoritetin të mbajnë konsulta publike për çdo çështje që është në kompetencën e tyre.

Neni 18

18.1. Mënyra me të cilën do të zhvillohet konsultimi apo pjesëmarrja e publikut, do t'i bëhet e njohur opinionit publik së paku 14 ditë para mbajtjes dhe do të lejohet një kohë e duhur për përgatitjen e prezantimeve.

18.2. Të gjitha prezantimet e bëra do të shqyrtohen dhe bëhen publike para marrjes së vendimit përfundimtar.

Neni 19.

19.1. Të gjitha komunikimet duhet të jenë të qarta, të përfshijnë informatat e nevojshme në një dokument përmbledhës prej më së shumti dy faqesh, që përfshijnë çështjet dhe pyetjet kryesore për të cilat është diskutuar, në mënyrë që të interesuarit të përgjigjen, të kontaktojnë apo të ankohen.

19.2. Komuna duhet të sigurojë që palët pjesëmarrëse të kenë mundësinë t'i shprehin mendimet e tyre.

Neni 20

20.1 Komuna siguron publicitetin dhe format e komunikimit me publikun pa përjashtuar mjetet tjera të komunikimit, ndërkaq, konsultat e hapura për publikun duhet të publikohen në Web faqen zyrtare të komunës.

Neni 21

21.1 Komuna mundëson kohën e mjaftueshme për shqyrtimin e përgjigjeve më shkrim në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Qasje në dokumente zyrtare dhe të Rregullores komunale për Konsultim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje.

Kapitulli 2. Tubimet me Publikun

Neni 22

22.1. Komuna mbanë së paku 2 takime me publikun çdo vit, një në gjashtë mujorin e parë të vitit dhe një tjetër në gjashtë mujorin e dytë.

22.2. Vendi, data dhe koha e mbajtjes së takimit publik duhet të shpallet së paku 14 ditë para mbajtjes së takimit.

22.3. Në takim duhet të ftohen edhe përfaqësuesit e mediave.

Neni 23

23.1. Kryetari i Komunës apo përfaqësuesi i tij, do t'i kryesojë takimet me publikun.

23.2. Kryetari apo përfaqësuesi i tij duhet të përcaktojë procedurën e cila do të shfrytëzohet gjatë takimit dhe nuk do të lejojë diskutime për çështje të cilat nuk janë në rend dite apo që nuk janë në kompetencë dhe përgjegjësi të komunës.

23.3. Çështja e takimeve me qytetarë më për së afërmi rregullohet më Rregulloren e veçantë komunale për Konsultim dhe pjesëmarrje të publikut në vendimmarrje.

Neni 24

24.1 Nëse në takimin me qytetarë shtrohet ndonjë pyetje e cila nuk do të mund të marr përgjigje gjatë këtij takimit, Komuna është e detyruar që parashtruesit të pyetjes t'i kthej përgjigjen me shkrim në afat prej 30 ditësh, pas ditës së takimit.

Neni 25

25.1. Procesverbali me të gjitha informatat e takimit me publikun ruhet në Komunë dhe të njëjtit i bashkëngjiten të gjitha përgjigjet e dhëna me shkrim.

25.2. Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të shqyrtoj procesverbalin e takimit publik brenda 60 ditëve pas mbajtjes së takimit, brenda të cilit afat shqyrton secilin propozim të dhënë gjatë takimit dhe bënë rekomandimet e duhura për seancën e ardhshme të Kuvendit të Komunës.

Peticioni

Neni 26

26.1. Në pajtim me dispozita e nenit 69. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, çdo qytetarë apo person juridik i cili ka interes për çfarëdo çështje lidhur me përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës, ka të drejtë që me vetë iniciativë, përmes formës së petitionit t'i propozojë Kuvendit të Komunës nxjerrjen e akteve juridike me të cilat do të zgjidhen çështjet e rëndësishme për qytetin, fshatin, vendbanimin dhe lagjen urbane në pajtim me këtë Statut.

26.2. Subjektet e përmendura më lartë mund t'i drejtohen me petition Kuvendit të Komunës për çështjet që janë në kompetencë të tij e që kanë të bëjnë me:

- a) Rregullimin e qytetit;
- b) Mirëmbajtjen e rendit dhe të infrastrukturës së Komunës;
- c) Urbanizimin e qytetit;
- d) Mirëmbajtjen e mjedisit jetësor;
- e) Organizimin e referendumit;
- f) Çështje të tjera të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve dhe Komunës.

26.3. Një nismë e tillë e subjekteve fillon me nënshkrimin e tyre në formë të petitionit me propozimet e veçanta për çështje të caktuar dhe i drejtohet Kryetarit të Komunës dhe Kuvendit të Komunës.

26.4. Kuvendi i Komunës mund të delegojë shqyrtimin e peticioneve të tilla në ndonjë Komitet të përhershëm.

26.5 Çdo petition duhet të përmbajë emrin dhe mbiemrin e parashtruesit, emrat e nënshkruesve si dhe lëndën e petitionit.

26.6 Peticioni i cili nuk përmban elementet e përcaktuar në paragrafin e mësipërm, nuk do të konsiderohet i vlefshëm dhe nuk do të shqyrtohet.

Referendumi

Neni 27.

27.1 Në rastet kur, për çështje me interes të përgjithshëm Kuvendi i Komunës nuk mund të marrë vendim përfundimtar, atëherë Kuvendi në procedurë të veçantë merr vendim për shpalljen e Referendumit si forma më demokratike e deklarimit personal të qytetarëve të Komunës me të drejtë vote.

Kapitulli i 3: Komitetet Këshillë-dhënëse Komunale

Neni 28

28.1. Kuvendi Komunal themelon Komitetet këshillë-dhënëse sektoriale, si trupa ndihmëse profesionale që do të mundësonin pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes.

28.2 Kuvendi i Komunës në përbërjen e këtyre komiteteve siguron një strukturë të gjerë të përfaqësimit nga sferat e ndryshme të shoqërisë, komuniteteve dhe fshatrave brenda Komunës duke marrë parasysh balancën gjinore.

Neni 29

29.1 Komitetet këshillë-dhënëse paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve në Kuvendin e Komunës, monitorojnë ofrimin e shërbimeve në sektorët e ndryshëm komunal dhe japin propozime konkrete profesionale për përmirësimin apo zgjidhjen e problemeve të identifikuara dhe punojnë së bashku me Komitetet e Kuvendit në atë mënyrë që vendimet e Komiteteve të Kuvendit të merren pas konsultimit me Komitetet këshillë-dhënëse sektoriale.

Neni 30

30.1 Anëtarët e Komiteteve këshillë-dhënëse emërohen me mandat 3 vjeçar.

30.2 Asnjë anëtarë i Komitetit këshillë-dhënës nuk mund të shërbejë më shumë se dy mandate të një pas njëshme.

Kapitulli i 4. Qasja në Dokumentet Zyrtare

Neni 31

31.1 Çdo qytetar ka të drejtë në shikimin e dokumenteve zyrtare të organeve komunale në pajtim me Ligjin mbi Qasjen në dokumente zyrtare.

PJESA E IV. KUVENDI I KOMUNËS, KRYESUESI, ZËVENDËSKRYESUESI I KUVENDIT DHE KOMITETET E KUVENDIT

Kuvendi i Komunës

Neni 32

32.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës i Komunës i cili ushtron funksionet e pushtetit lokal të përcaktuara me ligj dhe Statut.

32.2 Kuvendin e Komunës e përbëjnë 31 Këshilltarë.

32.3 Kuvendi zgjedhet në mënyrë të drejtpërdrejtë në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Zgjedhjet Lokale.

32.4 Mandati i anëtarëve të Kuvendit është 4 /katër/ vjet.

32.5 Kuvendi i Komunës miraton Statutin dhe ndryshon atë nëse konsideron se një gjë e tillë është e nevojshme.

32.6 Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Statutit miratohet me më shumë se 2/3 e votave të anëtarëve të Kuvendit.

32.7 Kuvendi i Komunës miraton Rregulloren e punës së Kuvendit dhe të njëjtën mund ta ndryshojë sipas nevojës.

32.8 Vendimi për miratimin apo ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit merret nga më shumë se gjysma e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kompetencat jo deleguese të Kuvendit të Komunës

Neni 33

33.1 Kompetencat të cilat Kuvendi i Komunës nuk mund t'i delegojë në organe të tjera janë:

1. Miratimin e Statutit dhe Rregulloren e punës, rregulloret tjera komunale, miratimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e tyre,
2. Miratimin e buxhetit dhe planeve investuese,
3. Miratimin e çështjeve tjera financiare, të cilat janë të rezervuara për Kuvendin sipas Statutit dhe rregullores së punës,
4. Planin vjetor dhe raportin vjetor,
5. Themelimin e Komisioneve të kërkuara sipas Ligji për Vetëqeverisjen Lokale,
6. Niveli i tarifave dhe ngarkesave,
7. Krijimin dhe përdorimin e simboleve, dekoratave dhe titujve të nderit të Komunës, në pajtim me Ligjin në fuqi,
8. Emërimin dhe riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike,
9. Arritjen e marrëveshjeve ndërkomunale dhe brenda komunale,
10. Marrjen e vendimeve për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të Komunave të Republikës së Kosovës dhe,
11. Përgjegjësi të tjera që kërkojnë me Ligj.

Neni 34

34.1 Procedura për hartimin dhe ndryshimin e rregulloreve komunale bëhet si në vijim:

34.2 Kryetari bënë propozimin për hartimin e rregulloreve komunale lidhur me çështjet nga përgjegjësitë e Komunës; projekt-rregulloret i prezantohen KPF-së për shqyrtim, i cili pas shqyrtimit ia kalon Kuvendit të Komunës për procedim të mëtejshëm. Kuvendi i Komunës pas pranimit të projekt-rregullores shpall diskutimin publik për to. Diskutimi publik zgjatë 15 ditë. Pas mbarimit të diskutimit publik projekt-rregullorja me vërejtjet e qytetarëve të dhëna në to i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. Rregulloret komunale miratohen me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë.

34.3 Vendimi për emërtimin apo riemërtimin e rrugëve, rrugicave apo vendeve tjera publike, miratohet nga më së pakut 2/3 e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

Kompetencat deleguese të Kuvendit të Komunës

Neni 35

35.1 Kuvendi i Komunës mund të delegoj të drejtën për të marrë vendime një Komiteti të Kuvendit të Komunës ose Kryetarit të Komunës.

35.2 E drejta e deleguar nga paragrafi i më sipërm, mund të revokohet në çdo kohë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Neni 36

36.1 Kuvendi i Komunës zgjedh Kryesuesin e Kuvendit të Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

36.2 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës zgjedhet për një mandat të njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit.

36.3 Votimi për të gjitha zgjedhjet për Kryesues të Kuvendit të Komunës është më vota të fshehta.

36.4 Për t'u zgjedhur në votimin e parë, kandidati duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur.

36.5 Në rast se në votimin e parë asnjëri prej kandidatëve nuk e siguron shumicën e kërkuar, atëherë dy kandidatët me numrin më të madh të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të zgjedhur, do të zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës.

Zëvendëskryesuesi i komuniteteve

Neni 37

37.1 Postin e zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës për komunitete e mban kandidati përfaqësues i popullatës jo shumicë i cili ka marrë më shumë vota në listën e hapur të kandidatëve në zgjedhjet për Kuvend të Komunës.

Mbledhja inauguruese

Neni 38

38.1 Mbledhja inauguruese thirret nga Kryetari i Komunës (nëse është zgjedhur) brenda 15 ditësh nga dita e certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve.

38.2 Nëse Kryetari nuk e thërret mbledhjen sipas paragrafit 1, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës do të thirret nga anëtari më i vjetër i

zgjedhur i Kuvendit të Komunës në afat prej 15 ditësh nga dita kur Kryetari është dashur ta thërret mbledhjen inauguruese të Kuvendit.

38.3 Nëse anëtari më i vjetër i Kuvendit nuk e thërret mbledhjen sipas paragrafit 2 të këtij neni, mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës mund të thirret me iniciativën e shumicës së anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës.

38.4 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës të cilat mbahen para zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, kryesohen nga anëtari më i moshuar i Kuvendit të Komunës i cili është prezent në mbledhje.

38.5 Gjatë mbledhjes inauguruese të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit (pas verifikimit të mandatit nga Komisioni) japin betimin si dhe nënshkruajnë deklaratën e betimit me përmbajtje si në vijim:

“Betohe (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t’i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Istogut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kuorumi dhe mbledhjet e Kuvendit të Komunës

Neni 39

39.1 Kuorumi për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës si dhe Komiteteve të tij është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

39.2 Kuorumi duhet të verifikohet para çdo vendimi të marrë.

Vendimmarrja në Kuvend Komunal dhe Komitete

Neni 40

40.1 Vendimet në Kuvendin e Komunës dhe Komiteteve të tij merren me votim të hapur me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm të cilët votojnë, përveç nëse me Ligj për vetëqeverisjen lokale dhe këtë Statut kërkohet ndryshe.

40.2 Në të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, çdo anëtar, përfshirë edhe Kryesuesin, ka një votë, por Kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.

40.3 Kuvendi i Komunës mbledhet së paku dhjetë herë në vit, por mund të thirret edhe më shpesh sipas nevojës, në pajtim me Rregulloren e punës.

40.4 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës gjithashtu mund të thirren nga 1/4 e numrit të të gjithë anëtarëve të zgjedhur, ose nga njëra prej Komiteteve të Kuvendit të Komunës.

40.5 Së paku shtatë ditë pune para çfarëdo mbledhjeje të Kuvendit të Komunës ose ekskluzivisht tri ditë pune më herët në raste urgjente, anëtarët e Kuvendit duhet të njoftohen për kohën, datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes si dhe për rendin e ditës së asaj mbledhjeje edhe materiali për pikat e rendit të ditës.

40.6 Njoftimet publike për këto çështje shpallen në të njëjtën kohë.

Procesverbali

Neni 41

41.1 Për të gjitha mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të tij mbahet procesverbali. Procesverbali përfshinë emrat e këshilltarëve të pranishëm dhe anëtarëve të ftuar, rendin e ditës, thelbin e diskutimit, rezultatin numerik të votimit dhe propozimet e miratuara apo të refuzuara. Nëse kërkohet të thirret emri i çdo këshilltari, në procesverbal shënohet si ka votuar secili.

41.2 Kryesuesi e nënshkruan procesverbalin e miratuar.

Komitetet e përhershme komunale dhe Komitetet tjera

Neni 42

42.1 Kuvendi i Komunës themelon Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete si komitete të përhershme.

42.2 Kuvendi i Komunës mund të themelon komitete të tjera për të cilat konsideron se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësive të tij.

42.3 Nëse nuk parashihet ndryshe me ligj, komitetet reflektojnë përbërjen e Kuvendit të Komunës.

Komiteti për politikë dhe financa

Neni 43

43.1 Komiteti për politikë dhe financa kryesohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe përbërja e tij duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike në Kuvendin e Komunës.

43.2 Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.

Neni 44

44.1 Të gjithë anëtarët e KPF-ës duhet të emërohen nga radhët e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

44.2 Anëtarësimi në çdo rast duhet të pasqyrojë sa më për së afërmi proporcionin e nivelit të përfaqësimit të partive politike dhe përfaqësimin gjinor në Kuvendin e Komunës nëse nuk parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

44.3 Anëtarët e KPF-a nuk kanë të drejtë të jenë anëtarë të komiteteve të tjera.

44.3 Numri i anëtarëve të KPF-a duhet të jetë së paku 5 e më së shumti 9 anëtarë.

Komiteti i komuniteteve

Neni 45

45.1 Komiteti për komunitete përfshinë në radhët e veta shumicën e thjeshtë nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, anëtarët tjerë janë përfaqësuesit e komuniteteve. Çdo komunitet që jeton në komunë përfaqësohet nga, së paku një përfaqësues në Komitetin për komunitete. Përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë në Komunë e përbëjnë shumicën e anëtarëve të Komitetit për komunitete.

45.2 Komiteti i komuniteteve është përgjegjës për shqyrtimin e përputhshmërisë së autoriteteve komunale me ligjin në zbatim dhe për shqyrtimin e të gjitha politikave komunale, praktikave dhe aktiviteteve për t'u siguruar se të drejtat dhe interesat e komuniteteve respektohen plotësisht. Komiteti gjithashtu i rekomandon Kuvendit të Komunës masat që duhet të ndërmarrën për të siguruar jetësimin e dispozitave që kanë të bëjnë me nevojën e komuniteteve për t'u avancuar, shprehur, mbrojtur dhe zhvilluar identitetin e tyre etnik, kulturor, fetar dhe gjuhësor, si dhe për të siguruar mbrojtje adekuate të të drejtave të komuniteteve brenda komunës.

45.3 Numri i anëtarëve të Komitetit të Komuniteteve duhet të jetë së paku 5 e më së shumti 9 anëtarë.

Neni 46

46.1 Komitetet tjera të përcaktuara me nenin 42 alineja 2 të këtij Statuti në përbërjen e tyre shumica e anëtarëve emërohen nga anëtarësia e Kuvendit të Komunës duke respektuar përfaqësimin e partive politike dhe përfaqësimin gjinor.

46.2 Emërimi i anëtarëve të cilët nuk janë anëtarë të Kuvendit të Komunës duhet të bëhet duke respektuar përvojën adekuate dhe kriteret profesionale.

Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve

Neni 47

47.1 Në takimet e para të çdo vit fiskal Komitetet e përhershme duhet t'i caktojnë data fikse në të cilat do të mbahen takimet e rregullta gjatë atij vitit.

47.2 Data e mbajtjes së takimeve mund të ndryshohet me vendimet pasuese.

47.3 Takimet tjera mund të thirrën në çdo kohë.

47.4 Të gjitha takimet duhet të thirrën dhe të mbahen në pajtueshmëri me Rregulloren e punës.

Neni 48

48.1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës i thërret dhe kryeson Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

48.2 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve të përhershme janë të hapura për publikun, për përfaqësuesit e mjeteve të informimit dhe për

subjekteve të tjera të interesuara, përveç nëse për këtë parashihet ndryshe më legjislacionin në fuqi.

48.3 Zyra e informimit njofton publikun të paktën 7 ditë para mbledhjeve të rregullta ose 3 ditë para mbajtës se mbledhjeve të jashtëzakonshme.

48.4 Informimi bëhet në mjetet e informimit siç vijon:

1. Shpallja publike në vendet me të frekuentuara në territorin e Komunës,
2. Mediat e shkruara dhe elektronike vendore dhe
3. Në Web faqen zyrtare të Komunës.

Njoftimet publike duhet të përmbajnë:

- datën,
- orën,
- vendin dhe
- rendin e ditës.

48.5 Komitetet përmes zyrës përgjegjëse për informim njoftojnë publikun 3 ditë para datës së caktuar për mbajtjen e mbledhjeve të tyre, ndërkaq, përmbajtja e njoftimit është e njëjtë si nga alineja 4 e këtij neni.

48.6 Kuvendi i Komunës, apo Komiteti, me votën e shumicës, mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi, apo nga një pjesë e tij, në rastet kur:

- a) mendohet se mbajtja e një takimi të hapur mund të shpije deri te një çrregullim publik apo dhunë;
- b) takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione [dhe dokumente], të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas Ligjit mbi Qasjen në dokumentet zyrtare;
- c) kërcënon të zbulojë informacione të ndjeshme personale apo komerciale ose
- d) informacione lidhur me procedurat gjyqësore të tanishme apo të ardhshme.

48.7 Në rastet e tilla, Kuvendi i Komunës njofton për vendimin e marrur.

Neni 49

49.1 Çdo qytetar i cili merr pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe Komitetet e tij, më lejen e Kryesuesit të takimit mund të bëjë pyetje dhe mund t'i drejtohet Kuvendit dhe Komiteteve në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve si dhe akteve të tjera që rregullojnë këtë çështje.

Rendi i ditës

Neni 50

50.1 Rendi i ditës për takimin e Kuvendit të Komunës caktohet nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës në marrëveshje me Kryetarin e Komunës.

50.2 Anëtari i Kuvendit të Komunës mund të kërkojë shtimin e një pikë në rendin e ditës gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërkohet të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente me rëndësi publike.

- 50.3 Kërkesa e tillë mund të miratohet apo refuzohet me votën e shumicës.
- 50.4 Rregullorja e punës së Kuvendit të Komunës parasheh dispozita tjera për përgatitjen, miratimin dhe ndryshimin e rendit të ditës.

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës

Neni 51

- 51.1 Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës caktohet me kërkesën e bërë me shkrim nga, më së paku, një e treta (1/3) e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit të Komunës apo me kërkesë të Kryetarit.
- 51.2 E drejta për të thirrur një takim të jashtëzakonshëm gjithashtu përfshinë të drejtën për caktimin e rendit të ditës për takimin e caktuar.
- 51.3. Pikat e caktuara në rendin e ditës për mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk mund të ndryshohen gjatë mbledhjes.
- 51.4 Takimi i jashtëzakonshëm i Kuvendit të Komunës nuk mbahet nëse të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe publiku nuk janë njoftuar me shkrim, siç kërkohet me rregulloret e punës, së paku tri (3) ditë pune para datës së mbajtjes së takimit.
- 51.5 Procedurat e njëjta që kërkohen për njoftimin dhe çështjet e tjera që zbatohen për mbledhjet e rregullta, zbatohen për mbledhjet e jashtëzakonshme gjithashtu.
- 51.6 Procedurat e lartpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

PJESA E V. INFORMIMI PËR ANËTARËT E KUVENDIT TË KOMUNËS

Neni 52

- 52.1 Kërkesat për informata prej anëtarëve të Kuvendit të Komunës që kanë të bëjnë me çështjet komunale, adresohen me shkrim te zyrtari përgjegjës i Komunës, nga i cili kërkohen informatat.
- 52.2 Zyrtari përgjegjës i Komunës në afat prej 15 ditëve duhet t'i përgjigjet me shkrim anëtarit ose anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
- 52.3 Një kopje e kërkesës dhe e përgjegjës duhet të futet në regjistër nga zyrtari përgjegjës komunal, i cili duhet të shënoj datën e kërkesës së pranuar dhe datën e përgjegjës së dhënë.

Kapitull i 1. Kompensimi i Anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Neni 53

53.1 Kompensimi për anëtarët e Kuvendit të Komunës dhe anëtarëve të Komiteteve për punën që ata bëjnë për Komunën, do të caktohet nga Kuvendi konform Udhëzimit Administrativ për pagesën e stafit politik të Komunës.

Kapitulli 2. Konflikti i Interesit i Anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Neni 54

54.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës apo anëtari i Komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

54.2 Çdo anëtarë duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.

54.3 Para mbledhjes së parë të Kuvendit të Komunës, anëtarët e Kuvendit duhet t'i regjistrojnë deklaratat e plota dhe të hapura rreth interesave të tyre financiare në një regjistër publik të cilin e mbanë zyrtari përgjegjës. Anëtarët duhet të shënojnë çdo ndërrim të gjendjes së tyre financiare posa ato të ndodhin.

Neni 55

55.1 Anëtarët që kanë konflikt të interesit në lidhje me një çështje të caktuar, nuk kanë të drejtë të flasin e as të votojnë për çështjen për të cilën kanë konflikt të interesit dhe duhet të dalin nga salla e mbledhjes atëherë kur diskutohet ajo çështje.

55.2 Nëse vije deri të ndonjë konflikt potencial i interesit pasi që është marrë vendimi, por para se të zbatohet ai, vendimi duhet të suspendohet dhe çështja duhet të hetohet.

55.3 Nëse arrihet në përfundim se ka ekzistuar konflikti i interesit, vendimi duhet të anulohet tërësisht dhe duhet të bihet një vendim i ri.

Shkarkimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës

Neni 56

56.1 Anëtari i Kuvendit të Komunës pushon të jetë anëtar:

- a) me rastin e përfundimit të mandatit të tij;
- b) nëse ai/ajo ndërron vendbanimin ku është zgjedhur;
- c) nëse anëtari ia paraqet Kryetarit të Komunës dorëheqjen me shkrim nga posti i tij;

- d) nëse anëtari ka qenë i dënuar për ndonjë vepër penale dhe është lëshuar urdhri për burgim për gjashtë ose më shumë muaj;
- e) nëse anëtari nuk merr pjesë tre (3) muaj rresht në mbledhjet e Kuvendit të Komunës pa arsye;
- f) nëse ligji në fuqi, apo ndonjë ligj tjetër i zbatueshëm s'kualifikon apo e konsideron të pa përzgjedhshëm.

56.2 Anëtari i Kuvendit të Komunës në të njëjtën kohë nuk mund të jetë deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kapitulli i 3. Marrëdhëniet ndër-komunale

Neni 57

57.1 Kryetari i Komunës pas konsultimeve me Komitetin për Politikë dhe Financa duhet të prezantojë rekomandimet për Kuvendin e Komunës për marrëveshjet të cilat mund të jenë të nevojshme në bazë të nenit 28 dhe 29 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, marrëveshje këto ndërmjet komunave për ushtrimin e përgjegjësisë dhe pushtetit në bashkëpunim me njëra tjetrën.

57.2 Kryetari i Komunës duhet të prezantojë rekomandimet e tij te Kuvendi i Komunës në lidhje me menaxhimin e ndërmarrjeve komunale dhe a janë të nevojshme ato marrëveshje, marrëveshje këto ndërmjet komunave që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e shërbimeve të përbashkëta publike lokale të cilat ushtrohen në më shumë se një komunë.

Neni 58

58.1 Kuvendi i Komunës, brenda kornizës së ligjit mund të bëjë marrëveshje që të bashkëpunojë dhe formoj partneritete me Kuvendet tjera komunale ashtu që të kryejnë detyrat që janë në interes të përbashkët.

58.2 Kuvendi i Komunës mund të bashkohet me Kuvendet e tjera komunale në asociacione për mbrojtjen dhe promovimin e interesave të përbashkëta.

Kapitulli i 4. Financat Komunale

Parimet themelore të financave komunale

Neni 59

59.1. Komuna ka buxhetin dhe financat e veta për financimin e kompetencave të veta

59.2 Buxheti komunal përbëhet prej të hyrave vetanake, grandeve nga Qeveria e Republikës së Kosovës, donacioneve dhe të hyrave të tjera.

59.3 Të gjitha çështjet që janë të lidhura me përgatitjen e buxhetit dhe menaxhimin publik financiar të Komunës janë të rregulluara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësit dhe Ligjin për financat e pushtetit lokal.

Përgatitja e buxhetit komunal si dhe konsultimi me publikun

Neni 60

60.1 Zyrtari Kryesor Financiar para 1.(një) korrikut ose me 1. korrik të vitit aktual kalendarik i dërgon secilit Drejtor të Drejtorateve Komunale qarkoren buxhetore komunale e cila përmban informata dhe udhëzime mbi tavanet e shpenzimeve për Drejtoratet përkatëse për vitin e ardhshëm fiskal si dhe vlerësimet mbi këto tavane për dy vitet e ardhshme fiskale me kërkesën për ndarjen buxhetore dhe metodologjinë e përgatitjes buxhetore.

Qarkorja buxhetore komunale

Neni 61

61.1 Qarkorja buxhetore komunale përmban:

- a) procedurat që duhet përdorur gjatë përgatitjes së propozim-buxhetit dhe kërkesën për ndarje buxhetore,
- b) të dhënat të cilat parashtrihen në propozim-buxhet dhe në kërkesën për ndarje buxhetore,
- c) detalet mbi formatin në të cilin përgatitet propozim-buxheti dhe
- d) afatin e fundit deri kur Drejtoratet duhet t ia dorëzojnë Zyrtarit Kryesor Financiar propozimet për buxhet dhe kërkesën për ndarje buxhetore.

Neni 62

62.1. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në qarkoren e brendshme buxhetore, Zyrtari Kryesor Financiar shqyrton propozim-buxhetin dhe kërkesat për ndarje buxhetore të cilat janë dorëzuar nga e Drejtoritë Komunale dhe pastaj mban takime me secilin Drejtorat me qëllim të shqyrtimit të propozimeve buxhetore dhe shqetësimeve eventuale.

62.2. Pas mbajtjes së takimeve të parapara, Zyrtari Kryesor Financiar, përgatit Buxhetin e propozuar Komunal dhe ia dorëzon Kryetarit të Komunës për vitin e ardhshëm fiskal dhe vlerësimet për dy vitet e ardhshme dhe pastaj iu shpërndahen edhe Drejtorateve komunale.

Shqyrtimi dhe aprovimi i Buxhet

Neni 63

63.1. Pas Miratimit të propozim-buxhetit nga Kryetari i Komunës, i njëjti më së largëti deri me 1.(një) shtator të vitit përkatës fiskal ia dorëzon Kuvendit Komunal për diskutim dhe miratim.

63.2 Pas pranimit të propozim-buxhetit, Kuvendi Komunal do të mbaj dëgjime publike në përputhje me procedurat e përkatëse. Pas dëgjimit publik, Kuvendi Komunal bënë shqyrtimin e propozimeve, dhe në fund bënë aprovimin e propozim-buxhetit me ndryshimet e arsyeshme sipas nevojës dhe pas aprovimit, propozim-buxhetin ia dorëzon Ministrisë për Financa me së largëti deri me 30. shtator të vitit paraparak fiskal.

Auditimi i brendshëm

Neni 64.

64.1 Komuna ka obligim ligjor që së paku një herë në vit të bëjë auditivin e brendshëm.

64.2 Komuna sipas këtij obligimi ligjor ka të themeluar shërbimin e auditivit të brendshëm i cili vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Kapitulli i 5. Raporti vjetor

Neni 65

65.1 Komuna e publikon raportin vjetor pas përfundimit të çdo viti fiskal të Komunës. Raporti i prezantohet Kuvendit të Komunës për miratim jo më vonë se 30 maj të vitit vijues. Raporti duhet të përmbledhë objektivat e komunës në lidhje me veprimtaritë e saj për të cilat është përgjegjëse dhe duhet të vlerësojë nivelin e realizimit të objektivave për atë vit fiskal. Raporti duhet të sqarojë mënyrën e financimit të secilit prej aktiviteteve dhe duhet të tregojë gjendjen financiare të Komunës në fund të atij viti fiskal. Ai duhet të përfshijë edhe deklaratat mbi kontrollat financiare. Këto kërkesa duhet të përfshijnë edhe veprimtaritë e ndërmarrjeve komunale, përkrahjen e dhënë organizatave jofitimprurëse si dhe marrëveshjet e bëra me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Neni 66

66.1 Në mënyrë që të përmbushen përgjegjësitë për raportim të Kryetarit të Komunës dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, duhet të ndërmerren veprimet si në vijim:

1. Në çdo Buxhet vjetor duhet të përfshihen objektivat e Komunës në lidhje me aktivitetet për të cilat është përgjegjëse Komuna.

2. Objektivat duhet të mbahen nën mbikëqyrje të vazhdueshme
3. Duhet të ndërtohen mekanizmat përmes të cilëve monitorohet arritja e objektivave
4. Të identifikohen nevojat aktuale dhe ato të ardhshme dhe të përcaktohen mjetet përmes të cilave sigurohet përmbushja e tyre.

PJESA VI: EKZEKUTIVI I KOMUNËS

Kapitulli i 1: Kryetari i Komunës

Neni 67

67.1 Kryetari i Komunës është udhëheqës i organit ekzekutiv të komunës dhe zgjidhet drejtpërdrejtë nga qytetarët me të drejtë vote, në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet Komunale që është në fuqi.

67.2 Kryetari i Komunës zgjidhet për mandat katër vjeçar.

67.3 Mandati i Kryetarit të Komunës përfundon në pajtim me nenin 56 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, ndërkaq shkarkimi dhe largimi i tij bëhet në pajtim me nenin 64, përkatësisht 72 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Neni 68

68.1 Kryetari i Komunës i zbaton përgjegjësitë në vijim:

- 1) përfaqëson Komunën dhe vepron në emër të saj;
- 2) udhëheq ekzekutivin e Komunës dhe administratën e saj dhe mbikëqyr administrimin financiar të Komunës;
- 3) ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të Komunës apo Komiteteve të tij;
- 4) ekzekuton aktet e Kuvendit të Komunës;
- 5) emëron apo shkarkon zëvendësit e tij/saj;
- 6) emëron dhe shkarkon anëtarët e tij të cilët i ndihmojnë atij në kryerjen e detyrave;
- 7) organizon punën dhe drejton politikën e Komunës;
- 8) propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës;
- 9) propozon zhvillimin komunal, planet rregullative dhe investuese, propozon buxhetin vjetor për miratim në Kuvendin e Komunës dhe e ekzekuton buxhetin e miratuar;
- 10) raporton para Kuvendit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të

- Komunës, së paku njëherë në gjashtë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga Kuvendi i Komunës; dhe
- 11) mund të kërkojë që Kuvendi i Komunës ta shqyrtojë një akt komunal para hyrjes në fuqi, kur konsideron se akti cenon legjislacionin në zbatim dhe/apo interesin e komuniteteve.
 - 12) do të konsultojë nënkryetarin për komunitete për çështjet që kanë të bëjnë me komunitetin jo shumicë; dhe
 - 13) Aktivitetet tjera që i caktohen me statut.

Neni 69

69.1 Përgjegjësitë tjera të Kryetarit të Komunës janë si në vijim:

1. Delegon përgjegjësi te Drejtorët e Drejtorateve dhe mbikëqyrë zbatimin e përgjegjësive të deleguara,
2. I jep propozime Kuvendit të Komunës për krijimin e ndërmarrjeve publike,
3. Bënë caktimin apo ndarjen dhe koordinimin e përkohshëm të punëve dhe përgjegjësive në mes të Drejtorive sipas nevojës, duke pasur për bazë lëmin apo projektin e caktuar,
4. Bie vendime, urdhëresa dhe akte të tjera juridike nga kompetencat dhe fushëveprimi i tij dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj
5. Kryetari i Komunës me Rregullore të veçantë përcaktojë strukturën dhe organizimin e administratës komunale duke përcaktuar numrin e drejtorive, emërtimin, formimin e njësive të veçanta në kuadër të Zyrës së Kryetarit dhe përshkrimin e kompetencave të drejtorive dhe njësive organizative.

Neni 70

70.1 Kryetari, për të ushtruar përgjegjësitë e përcaktuara me ligj ndihmohet nga Nënkryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorateve, duke i ofruar të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

Konflikti i interesit

Neni 71

71.1 Menjëherë pas zgjedhjes, Kryetari i Komunës ndërpre në çdo kontratë apo lidhje që ka, e cila mund ta vë në pikëpyetje aftësinë e tij për kryerjen e përgjegjësive të tij në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

71.2 Kryetari i Komunës përjashtohet nga procedurat vendimmarrëse dhe administrative që kanë të bëjnë me ndonjë çështje, në të cilën ai, apo ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal apo financiar.

71.3 Nga Kryetari i Komunës kërkohet t'i paraqesë konfliktet e interesit sapo të paraqiten ato.

71.4 Kryetari i Komunës mundet vullnetarisht ta përjashtojë veten nga vendimmarrja dhe procedurat administrative, nëse konsideron që mund të ketë konflikt të interesit. Kryetari i Komunës shënon çdo ndryshim në gjendjen financiare menjëherë pasi që ai të paraqitet.

Kapitulli i 2. Nënkyetari i Komunës

Neni 72

72.1 Komuna e Istogut do ta ketë edhe Nënkyetarin e Komunës.

72.2 Nënkyetari emërohet nga Kryetari për të njëjtin mandat dhe shkarkohet nga Kryetari.

72.3 Me kërkesë të kryetarit, Nënkyetari i ndihmon Kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij.

72.4 Kur posti i Nënkyetarit mbetet i lirë, Kryetari emëron Nënkyetarin e ri, jo më vonë se tridhjetë ditë pas paraqitjes së postit të lirë.

72.5 Neni 73 për konfliktet e interesit të Kryetarit zbatohet përshtatshmërisht (*mutatis mutandis*) edhe për Nënkyetarin.

Zyra komunale për Komunitete

Neni 73

73.1 Zyra komunale për komunitete është pjesë integrale e organizimit të administratës komunale.

73.2 Zyra komunale për komunitete është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe sigurimin e shërbimeve të barabarta publike në nivel komunal.

73.3 Udhëheqësi i Zyrës komunale për komunitete për punën e vet i përgjigjet Kryetarit të Komunës dhe i raporton Komitetit për Komunitete.

PJESA VII: DREJTORATET KOMUNALE

Neni 74.

74.1 Administrata komunale organizohet në Drejtorate.

74.2 Çdo Drejtorat komunal menaxhohet nga Drejtori i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari.

74.3 Drejtorët menaxhojnë dhe udhëheqin drejtoratin e tyre në përputhje me udhëzimet strategjike dhe politike të Kryetarit dhe në pajtim me ligjet dhe rregulloret komunale në fuqi.

74.4 Drejtorët i raportojnë rregullisht Kryetarit për çështjet që janë nën përgjegjësinë tyre dhe i ofrojnë atij të gjitha informatat dhe raportet e nevojshme për procesin e vendimmarrjes.

74.5 Numri dhe emërtimi i drejtorateve do të përcaktohet nga Kryetari i Komunës, varësisht prej përgjegjësiave dhe nevojave të organizimit të strukturave komunale duke pasur parasysh edhe implikimet buxhetore.

74.6 Në kuadër të drejtorateve mund të formohen sektorë të veçanta si njësi përbërëse e drejtoratit.

Konflikti i interesit të Drejtorëve

Neni 75.

75.1 Drejtorët përjashtohet nga marrja e vendimeve dhe nga procedurat administrative që kanë të bëjnë me çfarëdo çështjesh për të cilën ai apo ndonjë anëtar i ngushtë i familjes së tij ka ndonjë interes personal ose financiar.

75.2 Nga Drejtorët kërkohet që të paraqesin me shkrim çdo konflikt interesash menjëherë pasi shfaqen.

PJESA VIII: SHËRBIMI CIVIL KOMUNAL

Neni 76

76.1 Shërbimi Civil Komunal udhëhiqet në bazë të parimeve dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Me rastin e përzgjedhjes së personelit të komunës duhet respektuar procedurat e hapura dhe konkurruese për të pranuar shërbyes civil të komunës me cilësi të larta, në bazë të meritave dhe kompetencave.

76.2 Shërbimi Civil Komunal si tërësi duhet që të përmbajë proporcion të drejtë të përfaqësimit të personave me aftësi të kufizuar

Neni 77

77.1 Shërbimi Civil Komunal përfshinë të gjithë personat e punësuar nga autoriteti komunal, rroga e të cilëve paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, përveç:

- a) Kryetarit, Nënkryetarit/ve dhe Drejtorëve komunal;
- b) Kryesuesit, Zëvendëkryesuesit/ve dhe të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës;

77.2 Drejtorët komunal, Drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e Komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të Kuvendit të Republikës së Kosovës apo Kuvendit të Komunës.

77.3 Zgjedhjet për Kuvendin e Komunës nuk përbëjnë shkak për rishqyrtimin e emërimeve të shërbyesve civil.

Neni 78

78.1 Administrata komunale ka Udhëheqësin e Personelit i cili rekrutohet dhe largohet në pajtim me rregullat dhe procedurat ligjore të shërbimit civil në Republikën e Kosovës

78.2 Punësimi në shërbimin civil komunal mbikëqyret nga Udhëheqësi i personelit për të siguruar që shërbimi civil të reflektojë proporcion të drejtë profesional, gjinorë dhe etnik.

Neni 79.

79.1 Nëse posti i Udhëheqësit të personelit mbetet i zbrazët, Kryetari i Komunës emëron një anëtar të lartë të shërbimit civil komunal në cilësinë e kryesit të detyrës së udhëheqësit të personelit.

79.2 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, Kryetari rekruton udhëheqësin e personelit në pajtim me nenin 79.1.

Neni 80.

80.1 Nëpunësi i administratës komunale përjashtohet nga vendimmarrja dhe procedurat administrative lidhur me ndonjë çështje në të cilën ai apo ajo, ose ndonjë anëtar i afërm i familjes së tij, ka interes personal ose financiar.

Veprimet dhe aktet juridike

Neni 81.

81.1 Të gjitha organet e administratës komunale kur ndërmarrin veprime juridike duhet t'iu përmbahen dispozitave sistemore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligjeve, Statutit dhe akteve të tjera nënligjore në fuqi.

81.2 Gjatë ushtrimit të funksioneve të administratës-zbatimin e dispozitave dhe akteve të tjera, organet e administratës dhe udhëheqësit e tyre nxjerrin akte përkatëse juridike në pajtim me Kushtetutën, Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative dhe ligjet tjera të çështjes konkrete administrative.

81.3 Aktet juridike që i nxjerrin organet e administratës janë: rregulloret, vendimet, aktvendimet, udhëzimet, urdhëresat, konkluzionet dhe aktet e tjera juridike nënligjore në fushëveprimin e administratës.

81.4 Organet e administratës në bazë të kërkesës së palës dhe sipas detyrës zyrtare lëshojë edhe akte siç vijon: vërtetime, certifikata dhe akte të tjera sipas

evidencës zyrtare më të cilën disponon administrata në pajtim me LPA-në (Ligji i Procedurës Administrative).

Ankesa dhe mbrojtja juridike

Neni 82

82.1 Pala mund të parashtroj ankesë ose kundërshtim kundër Vendimeve apo aktvendimeve administrative të organit të administratës nëse mendon se me atë vendim apo aktvendim i janë cenuar të drejtat e tij.

82.2 Procedimi sipas ankesës do të bëhet në pajtim me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

Kapitulli i 1. Pasuria e Komunës

Neni 83

83.1 Komunat kanë të drejtë të posedojnë dhe menaxhojnë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme.

83.2 Komunat kanë të drejtë të shesin dhe japin me qira pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme sipas ligjit, me përjashtim të shitjes së tokës e cila rregullohet me ligj të posaçëm.

83.3 Komunat mbajnë dhe udhëheqin regjistrin e pronës së luajtshme dhe të paluajtshme që e kanë në shfrytëzim dhe posedim.

PJESA E IX. PROCEDURAT PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E STATUTIT

Neni 84.

84.1 Nismën për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës mund ta bëjë:

1. Kryetari i Komunës,
2. Kuvendi Komunal, përkatësisht, një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, si dhe
3. 10% e qytetarëve të Komunës më të drejtë vote.

84.2 Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit komunal fillimisht duhet të dërgohet në Kuvendin Komunal për shqyrtim fillestar.

84.3 Kuvendi Komunal para shqyrtimit final duhet të konsultoj publikun në lidhje me atë propozim.

84.4 Kuvendi Komunal do të caktoj afatin prej 15. ditësh për përfundimin e konsultimit publik.

84.5 Pas përfundimit të konsultimit publik Kuvendi Komunal do të vendos se a do të miratoj ndryshimet dhe plotësimet e propozuara nga konsultimi publik.

84.6 Miratimi i Statutit të ndryshuar dhe plotësuar nga ana e Kuvendit Komunal do të bëhet me votim të hapet dhe me 2/3 e anëtarëve të Kuvendit

PJESA X: DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 85

85.1 Në rastet kur ekzistojë ndonjë konflikt midis dispozitave të Statutit me dispozitat e Ligjit për vetëqeverisjen lokale, atëherë aplikohen dispozitat e ligjit.

Neni 86

86.1 Statuti hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal dhe nënshkrimit të tij nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

Neni 87

87.1 Pas hyrjes në fuqi të këtij statuti, pushojnë të vlejnjë të gjitha dispozitat e Statutit të - mëparshëm: Rregullorja Komunale nr.1/2008, datës 29.04.2008.

Neni 88

88.1 Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Statutit të ri, të gjitha aktet tjera të Komunës do të harmonizohen me dispozitat e Statutit të miratuar.

Neni 89

89.1 Interpretimi autentik i këtij Statuti bëhet nga Kuvendi i Komunës .

**Kryesuesi i Kuvendit,
Demë Çeta**